

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë) ☐

ATLANTIK 3

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K22218003V

NUIS/NIPT

Autostrada Tirane - Durres, Km. 10, Rruga dytesore Vore - Albania

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692092619

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

atlantik_3@yahoo.com

E-mail

Administrator Ridjon Hoxha

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/04/17

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355674066111

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-65600-04-11-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Shkoder

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

2083333

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Materiale Pastrimi

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/04/25

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

Tipi i kontratës

Mallra

Data e zhvillimit të procedurës

2023/04/25

Numri i njoftimit

25042023

Kodi CPV

33770000-8 33711430-0 39224100-9 398312

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

Neni 3 i Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit ☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj. ☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. ☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër ☐

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

1. Referuar pikës 2.1 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, shtojca 7 kriteret e veçanta të kualifikimit “Objekti i veprimtarisë duhet të jetë i pasqyruar në objektin e veprimtarisë të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në QKB, ku të shprehet qartësisht ”MATERIALE PASTRIMI”.
2. Në pikën 2.3 kapaciteti teknik kërkohet “Subjektet ofertues duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin ku ndodhet institucioni e vërtetuar me dokumentacionin përkatës tekniko - ligjor (ambjente në pronësi apo me qera) (ose të kenë pikë kontakti në rrethin e Shkodrës si adresë të dytë, të vërtetuar me dokumentacion përkatës tekniko - ligjor, i regjistruar në qkr si adresë e dytë e ushtrimit të aktivitetit dhe i pajisur me vërtetim debie nga FSHU) pasi specifikat e këtij institucioni kërkojnë që furnizimi të garantohet në çdo ditë dhe çdo orë të kërkuar sipas kërkesave të AK deri më datë 15.12.2023”.
3. Në pikën 2.3 kapaciteti teknik kërkohet “Deri ditën e hapjes së ofertave operatorët ekonomik ofertues duhet të bëjnë paraqitjen e mostrave pranë protokollit të institucionit për të gjithë artikujt që janë pjesë përbërëse e preventivit. Mostrat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike, sipas të gjitha përcaktimeve të bëra nga AK. Mosparaqitja e mostrave ose mospërputhja me specifikimet teknike përbën kusht për skualifikim. Kostoja e paraqitjes së mostrave mbulohet nga vetë operatori ekonomik”.
4. Lidhur me pikën 5 të kapacitetit teknik kërkohet: “Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën dy mjete me ngarkesë deri 1 ton, për të bërë të mundur lëvrimin e produkteve të ofertuara në njësitë e AK. Për mjetin e marrë me qera nga një person juridik apo fizik tjetër, ofertuesi duhet ta shoqërojë me....”
5. Në pikën 7 dhe 8 kërkohet që “Mallrat duhet të jenë origjinal dhe të shoqëruara me certifikatë cilësie dhe origjine në momentin e dorëzimit të tyre si dhe Operatorët ekonomik duhet të paraqesim në SPE Certifikatën CE për të gjithë artikujt pjesë përbërëse të preventivit”.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

1. Lidhur me pikën 2.1 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, shtojca 7 kriteret e veçanta të kualifikimit ku kërkohet “Objekti i veprimtarisë duhet të jetë i pasqyruar në objektin e veprimtarisë të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në QKB, ku të shprehet qartësisht ”MATERIALE PASTRIMI”, kërkojmë të hiqet ky kufizim i cili pengon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar. Fusha e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë është mjaft e gjërë dhe jo detyrimsht duhet ta kenë të cituar materiale pastrimi pasi mund ta kenë dhe detergjentë pastrimi e cila është e njëjta gjë me materialet e kërkuara. Kufizime të tilla janë në shkelje të hapur të parimeve të prokurimit publik, duke e ngushtuar ndjeshëm konkurrencën dhe pjesëmarrjen në këtë procedurë. Sa më sipër kërkojmë modifikimin e kriterit në “Objekti i veprimtarisë duhet të jetë i pasqyruar në objektin e veprimtarisë të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në QKB, ku të shprehet qartësisht tregtimi i materialeve që janë objekt i kësaj procedurë”.
2. Përsa i përket kërkesës së Autoritetit Kontraktor në pikën 2.3 kapaciteti teknik ku kërkohet “Subjektet ofertues duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin ku ndodhet institucioni e vërtetuar me dokumentacionin përkatës tekniko - ligjor (ambjente në pronësi apo me qera) (ose të

kenë pikë kontakti në rrethin e Shkodrës si adresë të dytë, të vërtetuar me dokumentacion përkatës tekniko - ligjor, i regjistruar në qkr si adresë e dytë e ushtrimit të aktivitetit dhe i pajisur me vërtetim debie nga FSHU) pasi specifikat e këtij institucioni kërkojnë që furnizimi të garantohej në çdo ditë dhe çdo orë të kërkuar sipas kërkesave të AK deri më datë 15.12.2023”, kjo kërkesë është diskriminuese, pasi të gjithë operatorët ekonomikë në çdo vend që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, nëse tregëtojnë mallrat e kërkuara kanë të drejtën të ofertojnë për këtë procedurë prokurimi. Kërkesa e Autoritetit Kontraktor për furnizimin në çdo ditë dhe çdo orë të kërkuar sipas kërkesave të AK deri më datë 15.12.2023 është tepër e egzagjeruar dhe në shkelje të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Lëvrimi i mallrave bëhet sipas një kërkesë që duhet të bëjë Autoriteti Kontraktor minimalisht 24 (njëzet e katër) orë para që operatori ekonomik të përgatiti mallin me sasinë e kërkuar. Autoriteti Kontraktor e merr sasinë me pjesë dhe ka në dispozicion magazinën, nuk mund të marri mallin çdo ditë pasi kjo është teknikisht e pamundur, e rëndon operatorin me kosto të larta, duke rrezikuar realizimin e procedurës. Operatori ekonomik nuk mund të rri në çdo ditë dhe në çdo orë në dispozicion të vetëm një Autoriteti Kontraktor pasi ka dhe angazhime të tjera. Kjo kërkesë është e qëllimshme për të favorizuar vetëm operatorin që Autoriteti Kontraktor “dëshiron”. Për të rritur konkurrencën si dhe për të mundësuar trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë të intersuar duhet detyrimisht që ky kriter të hiqet.

3. Lidhur me kriterin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor “Deri ditën e hapjes së ofertave operatorët ekonomik ofertues duhet të bëjnë paraqitjen e mostrave pranë protokollit të institucionit për të gjithë artikujt që janë pjesë përbërëse e preventivit. Mostrat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike, sipas të gjitha përcaktimeve të bëra nga AK. Mosparaqitja e mostrave ose mospërputhja me specifikimet teknike përbën kusht për skualifikim. Kostoja e paraqitjes së mostrave mbulohet nga vetë operatori ekonomik”, sqarojmë se dorëzimi i mostrave duhet të bëhet në ditën dhe në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave të kësaj procedure për të mundësuar trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Procesi i dorëzimit të mostrave duhet të jetë sa më transparentë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

Kërkesa për dorëzimin e të gjithë artikujve të kërkuar është e ngarkuar. Në një procedurë të hapur të thjeshtuar të kërkohej 53 (pesëdhjetë e tre) artikuj për mostër i shkakton kosto operatorit ekonomik. Kriteret duhet të jenë sa më të hapura, proporcionale dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, për të mundësuar një pjesëmarrje sa më të madhe të operatorëve ekonomikë, duke mundësuar në këtë formë mirëpërdorimin e fondeve publik.

Sa me sipër, kërkojmë që lista e mostrave të shkurtohet duke lënë vetëm artikujtë me më shumë peshë ekonomike në ofertë, si dhe të modifikohet afati i dorëzimit të mostrave në ditën dhe në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave të kësaj procedure.

4. Lidhur me pikën 5 të kapacitetit teknik ku kërkohet: “Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën dy mjete me ngarkesë deri 1 ton, për të bërë të mundur lëvrimin e produkteve të ofertuara në njësitë e AK. Për mjetin e marrë me qera nga një person juridik apo fizik tjetër, ofertuesi duhet ta shoqërojë me....”, kërkojmë një modifikim të ngarkesës që mund të mbajë mjeti. Ngarkesa deri në 1 ton është penalizuese dhe kufizuese, pasi ka operatorë ekonomikë që kanë mjete të cilat mund të mbajnë ngarkesa dhe më shumë se 1 ton dhe kjo nuk mund ti përjashtojë nga pjesëmarrja. Kërkojmë modifikimin në “Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën dy mjete me ngarkesë minimale 1 ton, për të bërë të mundur lëvrimin e produkteve të ofertuara në njësitë e AK. Për mjetin e marrë me qera nga një person juridik apo fizik tjetër, ofertuesi duhet ta shoqërojë me....”

5. Lidhur me pikën 7 dhe 8 ku kërkohet që “Mallrat duhet të jenë origjinal dhe të shoqëruara me certifikatë cilësie dhe origjine në momentin e dorëzimit të tyre si dhe Operatorët ekonomik duhet të

paraqesim në SPE Certifikatën CE për të gjithë artikujt pjesë përbërëse të preventivit”, kërkojmë saktësimin e këtij kriteri në një të vetëm. Certifikata e origjinës dhe certifikata CE janë i njëjti dokumentë që lëshohet. Përveç certifikatës së cilësisë të lejohet dhe skeda me të dhënat e sigurisë (MSDS) e cila përmban dhe informacionin që ka certifikata e cilësisë. Kërkojmë të specifikohet lista e cila duhet të përmbajë dokumentacionin e kërkuar pasi për 53 (pesëdhjetë e tre) artikuj kjo është një kërkesë që pengon pjesëmarrjen dhe konkurrencën.

Referuar sa më sipër, që procedura të jetë në përputhje të plotë me qëllimin dhe parimet që ligji i prokurimit ka, kërkojmë që shkeljet e gjetura nga ana jonë të merren në shqyrtim dhe të ndryshohen që procedura të realizohet duke i trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët të cilët kanë interes për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme ☐

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

7. Lista e informacionit konfidencial: ☐

Nuk ka

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. ☐

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

atlantik_3@yahoo.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Ridjon Hoxha